



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Punëdhësi/Prodator Received/Delivery	21.12.2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinstvo Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHEK	8255	2022	114



## Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.999/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.999/2022 të datës 11.11.2022 të parashtruar nga ankuesja [redacted] me adresë banimi [redacted] kundër njoftimit me nr.06-111/01-39665 të datës 17.10.2022 të Njesisë së Burimeve Njerëzore Komuna e Drenasit, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 21.12.2022, mori këtë:

### V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar Ankesa me numër A.nr.999/2022 e datës 11.11.2022 e parashtruar nga ankuesja [redacted]

II. Mbetet në fuqi njoftimi me nr.06-111/01-39665 të datës 17.10.2022 të Njesisë te Burimeve Njerëzore në Komunën e Drenasit.

### Arsyetim

Ankuesja [redacted] ka aplikuar në konkursin e shpallur për grupin "Specialiste të punëve Sociale"-pozita „Zyrtar për Mirëqenie Sociale 1” me numër reference RN00009914 të shpallur prej datës 30.09.2022 deri me datën 10.10.2022 sipas njoftimit të datës 09.09.2022.



Sektori i Burimeve Njerëzore në kuadër të Komunës së Drenasit me njoftimin e datës 17.10.2022 për grupin "Specialist të Punëve Sociale"-pozita „Zyrtar për Mirëqenie Sociale 1” me numër reference RN00009914 të datës 09.09.2022 pas verifikimit paraprak ka njoftuar kandidatët që nuk i kanë plotësuar kriteret e konkursit, në mesin e tyre edhe kandidatja [REDAKTUAR]

Ankuesja e pakënaqur me njoftimin me nr.06-111/01-39665 të datës 17.10.2022 ka parashtruar ankesë në Njësinë e Burimeve Njerëzore në Komunën e Drenasit. Me vendimin me nr.06-111/01-39665 të datës 21.10.2022 Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Drenasit ka refuzuar ankesën e ankueses për mosplotësimin e kushteve të përgjithshme formale të konkursit të shpallur për pozitën Specialist të Punëve Sociale.

Kundër vendimit me nr.06-111/01-39665 të datës 21.10.2022 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore me datë 11.11.2022 ankuesja ka parashtruar ankesë me numër protokollit 7031/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, më datë 15.11.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Drenasit, ndërsa kjo e fundit me datë 23.11.2022 ka përcjell përgjigjen në ankesë me numër protokollit 7341/2022 së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e vendimmarrjes, ka administruar këto prova:** Ankesën me numër të protokollit 7031/2022 të datës 11.11.2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimi me nr.06-111/01-39665 të datës 17.10.2022 të Njesisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore; Njoftimi i datës 21.10.2022 për rezultatet e verifikimit paraprak të kandidatëve, grupi "Specialist të Punëve Soc dhe Informatikiale"; CV-për [REDAKTUAR] Kopja e konkursit; Diplomë e datës 29.10.2015 e lëshuar nga Kolegji AAB-Bachelor në Menaxhmentë dhe Informatikë; Kopja e letërnjoftimit; Çertifikatë e lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë; Përgjigje në ankesë nga organi i punësimit e datës 23.11.2022 me numër protokollit 7341/2022 bashkë me shkresat e lëndës; Kopj e konkursit; Lista e kandidatëve në pritje; njoftimi me nr.06-111/01-39665 të datës 17.10.2022; Njoftimi me nr.06-111/01-39665 të datës 17.10.2022 për kandidatët që nuk i plotësojnë kriteret për të vazhduar në procedurat e konkurrimit; Aplikacioni i datës 03.10.2022 me nr.reference RN00009914 për [REDAKTUAR] Vërtetim i datës 10.09.2013; Kontratë për themelimin e marrëdhënies së punës e datës 01.01.2020; Kontratë për themelimin e marrëdhënies së punës e datës 01.01.2021; Ankesë për Njësinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore; Refuzimi i aplikacionit; Vendimi i datës 21.10.2022 me nr.06-111/01-39665 i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Drenasit; E-mail zyrtar i datës 22.10.2022 dhe Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 15.11.2022 me numër protokollit 7113/2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të provave të lëndës, konstatoi se ankesa e ankueses [REDAKTUAR] është e pabazuar, **SEPSE:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës është konstatuar së më datë 09.09.2022 në Sistemin Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNJ) është shpallur njoftimi lidhur me hapjen e konkursit për grupin "Specialist të punëve sociale"- pozita „Zyrtar për Mirëqenie Sociale 1” me



numër reference RN00009914, dhe si kritere të përgjithshme formale për grupin "Specialist të Punëve Sociale" kanë qenë të përcaktuara:

**Arsimimi i kërkuar:** Diploma e studimeve universitare me të paktën 180 kredi/ECTS, *Administratë Publike. Shkenca Politike apo ekuivalente me to;*  
**Përvoja e punës:** nuk kërkohet

Sipas shkresave të lëndës rezultojnë se ankuesja me datë 03.10.2022 ka aplikuar në konkursin e shpallur për grupin "Specialist të punëve sociale"- pozita „Zyrtar për Mirëqenie Sociale 1” me numër reference RN00009914 në Komunën e Drenasit. Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Komunës së Drenasit me datë 17.10.2022 kanë njoftuar kandidatët që nuk i kanë plotësuar kriteret e konkursit.

Kundër njoftimit të datës 17.10.2022 ankuesja me datën 18.10.2022 ka parashtruar ankesë në Njësinë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Drenasit e cila pretendon se i ka plotësuar kriteret e konkursit për pozitën Specialist të Punëve Sociale.

Ankuesja [redacted] në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se i është bërë e pa drejtë nga Njësia e Burimeve Njerëzore me rastin e refuzimit të aplikacionit për grupin "Specialist i Punëve Sociale" pozita „Zyrtar për Mirëqenie Sociale 1” sepse e njëjta pretendon se i ka plotësuar kriteret e konkursit pasi që sipas ankueses Diploma Bachelor në Menaxhment dhe Informatikë e përfunduar në Kolegjin AAB është ekuivalente me *Administratë Publike dhe Shkenca Politike.*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave lidhur me pretendimet ankimore të ankueses ka shqyrtuar shkresat e lëndës një nga një dhe rrjedhimisht ka konstatuar se ankuesja [redacted] ka përfunduar studimet themelore me datë 29.09.2015 në Kolegjin AAB dhe ka marrë titullin Bachelor për Menaxhment dhe Informatik me gjithsej 180 kredi/ECTS.

Andaj, bazuar si me sipër Kolegji vlerëson se ankuesja me rastin e aplikimit për pozitën përkatëse të punës, ku afati i aplikimit ishte nga data 30.10.2022 deri me datë 10.10.2022, ankuesja nuk ka plotësuar kriterin e konkursit lidhur me arsimimin, ku përcaktohej: Diploma e studimeve universitare me të paktën 180 kredi/ECTS, *Administratë Publike. Shkenca Politike apo ekuivalente me to.* Në këtë kuptim Kolegji konstaton se pretendimet ankimore të ankueses janë të paqëndrueshme dhe rrjedhimisht vlerëson se Njësia për Burime Njerëzore, me rastin e nxjerrjes së vendimit me nr.06-111/01-39665 të datës 21.10.2022 për refuzimin e ankesës së ankueses për mosplotësimin e kërkesave të përgjithshme formale të konkursit si të pa bazuar ka vërtetuar drejte dhe në mënyrë të plote gjendjen faktike dhe rrjedhimisht drejte ka zbatuar ligjin material, duke vepruar kështu në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-144 për Zyrtaret Publikë, dhe nenit 15 paragrafi 3 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku përcaktohet se *3.Në përfundim të verifikimit paraprak, Njësia Përgjegjëse përcakton kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim. Vetëm kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurrimin në fazën e mëtejshme, e cila njihet si lista e ngushtë”.*

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.



Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr.999/2022, datë 21.12.2022

Sabile AVDYLI

*Sabile Avdyli*

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI BAJRAKTARI

*Malsore Gashi Bajraktari*  
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet;

- ❖ Ankueses [REDACTED]
- ❖ Kryetarit të Komunës së Drenasit;
- ❖ Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Drenasit; dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së.